

NGROHTORJA - QENDRËSHKËQËRJA E SHËRBUJTËS
PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Dt: 09.03.2023

Nr: 152

RREGULLORE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Gjakovë

Mars, 2023

Në mbështetje të nenit 34 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike lidhur me nenin 20 të Ligjit nr.04/L-111 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 9 të ligjit nr.04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, Bordi i Drejtorëve të "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. në Gjakovë me date 09.03.2023 aprovon këtë:

RREGULLORËN PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me qëllim të mbrojtjes së pasurisë dhe punonjësve nga zjarri, ndërmarrja është e obliguar të ndërmerr masa dhe veprime për zbulimin, evitimin, parandalimin e përhapjes së zjarrit dhe ndaljen e përhapjes së zjarrit, si dhe dhënien e ndihmës për evitimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Mbrojtja nga zjarri përfshinë një seri masash e veprimesh udhëheqëse, organizative, teknike, trajnuese dhe të natyrës informuese.
2. Mbrojtja nga Zjarri organizohet dhe zbatohet duke kontrolluar të gjitha objektet në kompleksin e NP "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A. Gjakovë, ku ekziston mundësia e rrezikut për shpërthimin e zjarrit.
3. Organizimi i punëve që kanë të bëjnë për mbrojtjen nga zjarri, janë të interesit të përbashkët për punonjësit të ndërmarrjes si tërësi, ato janë pjesë përbërëse e aktivitetit të punës, të cilat organizohen dhe obligon çdo punonjës të Ndërmarrjes për ndërmarrjen e masave preventive në parandalimin e zjarrit, i cili kishte me rreziku pasurinë dhe punonjësit e Ndërmarrjes.

II. OBLIGIMET DHE MËNYRA E ORGANIZIMI TË BRENDSHËM PËR MBROJTJE NDAJ ZJARRI

Neni 3

Obligimet e ndërmarrjes

1. NP "Ngrohtorja e Qytetit" Sh. A. është e obliguar që të gjithë punonjësi t'i aftësojë me njohuri për mbrojtje nga zjarri, një herë në tre vjet, kurse për çdo vit ta bëjë testimin praktik të këtyre njohurive.

2. Të harton planin mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë nga zjarri, të kenë numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë të trajnuar në këtë fushë dhe mund të kryejnë kujdestarinë e përhershme për fikjen e zjarrit dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri;
3. Të harmonizoj plani i mbrojtjes nga zjarri me planin komunal për mbrojtje nga zjarri.
4. Të njoftojë të gjithë punonjësit me mjetet kundër zjarrit, me detyrat e punës së tij/saj në rast të zjarrit në vendin e tij/saj të punonjëse, gjegjësisht objektin. Secili duhet të ketë njohuri elementare për punën dhe mënyrën e përdorimit të aparateve zjarrfikëse dhe fikjen e zjarrit dhe mjete tjera për fikje të cilat i posedon Ndërmarrja.
5. Të vendos shenjat e evakuimit emergjent përgjatë objektit dhe të përcaktohet vendi i sigurt jashtë objektit në rast të evakuimit.
6. Të siguroj qasje për automjete e zjarrfikëse nga të gjitha anët e objektit. Sipas dokumentacionit teknik, 5 hidrantë duhet të shtrihen në të dyja anët e ndërtesës. Qasja dhe intervenimi i automjeteve zjarrfikëse deri të ndërtesat bëhet nga rrugë e asfaltuar dy kahesh në të dy anët e ndërtesës.
7. Të ketë instaluar në ndërtesën administrative daljen emergjente dhe shkallët e emergjencës në katin e sipërm të ndërtesës. Evakuimi – i stafit dhe personave të tjerë duhet të bëhet nëpërmjet dyerve të cilat janë të shënuara me tabelat dhe udhëzimet për dalje emergjente me ndihmën e dyerve që hapen nga jashtë. Dyert duhet të jenë rezistente ndaj tymit dhe zjarrit për 90 minuta.
8. Të sigurojë mbrojtjen e objekteve dhe njerëzve në objekt nga zjarri i shkaktuar nga zbrazjet elektrike atmosferike nëpërmjet instalimit të rrejtës së rufepritësit me tokëzues.

Neni 4

Obligimet e Kryeshefit Ekzekutiv

1. Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes dhe udhëheqësi i shërbimeve në lidhje me mbrojtjen nga zjarri kanë këto të drejta dhe detyra:
 - a. Ushtrijnë shërbimet kujdesit të përgjithshëm për mbrojtje nga zjarri në lidhje me organizimin dhe punën në zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri;
 - b. Kujdesen për zbatimin e masave të parapara dhe të aprovuara nga organet kompetente për mbrojtje nga zjarri;
 - c. Kujdesen për zbatimin e vendimeve të organeve udhëheqëse lidhur me propozimet për masat që duhen ndërmarr për mbrojtje kundër zjarrit;
 - d. Kujdesen që pajimet teknike dhe mjetet tjera të nevojshme për mbrojtje nga zjarri dhe për fikjen e zjarrit të jenë të siguruara me kohë dhe në kuadër të planit të furnizimit në numër të mjaftueshëm;

- e. Ndërmarrin masa kundër punonjësve të cilët kanë shkelur detyrat e punës lidhur me mbrojtjen nga zjarri ose njerëzve që me sjelljet e tyre pengojnë marrjen e masave ose shkaktojnë rrezik nga zjarri;
- f. Urdhërojnë ndërprerjen e punës në objekte të caktuara ose në vende të punës, nëse kërcënohet rrezik i drejtpërdrejtë nga zjarri;

Neni 5

Obligimet e udhëheqësit të departamentit

1. Udhëheqësi i departamentit është i detyruar dhe përgjegjës për zbatueshmërinë e masave për mbrojtje kundër zjarrit dhe për kushtet dhe organizimin e procesit teknologjik, veçanërisht:
 - a. Kujdesen që hapësirat e objekteve të përcaktuara për deponimin e lëndëve djegëse, materialeve të gazta që rrezikojnë të ndezën dhe materialeve tjera të rrezikshme për shkaktim zjarri, t'i sistemojnë sipas planit nga organi kompetente për mbrojtje nga zjarri;
 - b. Që të sigurohen që në dokumentacionin tekniko-investues është dhënë mendimi i organit kompetent për atë se a janë paraparë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse nga zjarri;
 - c. Që kur ndërtohet, adaptohet ose rekonstruktohet objekti i ri ose ekzistues, instalimet dhe pajimet që përdorë kryesi i punëve t'u përmbahen dokumenteve të lejuara tekniko-investuese, masave të mbrojtjes nga zjarri të definuar me këtë Rregullore si dhe dispozitave ligjore në fuqi;
 - d. Që punët me flakë të hapur, me aparate për saldim të kryhen vetëm në vendet të sigurta nga zjarri dhe me marrjen e masave të detyrueshme për mbrojtje;
 - e. Që sistemi i monitorimit i instaluar për zbulim, lajmërim dhe pengim të shpërthimit të zjarrit, të mbahen në gjendje gatishmërie të përhershme;
2. Masat e mbrojtjes, të përmendura në këtë nen, udhëheqësit i marrin në bashkëpunim me shërbimin e Ndërmarrjes për mbrojtjes kundër zjarrit.

Neni 6

Obligimet e Udhëheqësit të Drejtpërdrejtë të Punonjësit

1. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë merr masa për mbrojtje nga zjarri dhe është përgjegjës kryesisht që:
 - a. Punët që kanë të bëjnë me operim më lëndë djegëse të caktoj punonjësit që janë të aftë dhe profesionalisht të aftësuar për këto punë;
 - b. Në zonat e rrezikshme të jap urdhëresë për ndalimin e mbajtjes së veglave apo pajisjeve të cilat u ekspozohen rreziqeve për vetëdezje, të ndaloj veglat dhe pajimet që shkaktojnë xixa, përdorimin e zjarrit të hapur në çfarëdo forme;

- c. Të shkyç nga puna çdo mjet pune dhe vegle e cila nuk është e vendosur sipas rregullit ose është defekt, ose çfarëdo mjeti a vegle e punës e cila mund të bëhet shkaktare e shpërthimit të zjarrit;
- d. Të ndalohet operimi me mjete dhe vegla pune punonjësve të cilët nuk janë të trajnuar të operojnë me to ose t'i mirëmbajnë;
- e. Në periudha të rregullta kohore të kërkojë të bëhet testimi i veglave dhe aparateve të punës të cilat kanë të bëjnë me elementet e dedikuara për mbrojtjen nga zjarri dhe shpërthimi;
- f. Të merr pjesë në organizimin e fikjes së zjarrit dhe shpëtimit të mirave materiale;
- g. Në rast incidenti në procesin teknologjik, menjëherë të ndërmerr masa në largimin e rrezikut nga zjarri, gjegjësisht të ndaloj çdo punë të mëtejme nëse rreziku nuk mund të largohet ndryshe;
- h. Gjatë servisimit apo mirëmbajtjes së stabilimenteve dhe mjeteve tjera të punës ku mund të lajmërohet rreziku i caktuar, ndërmerre masa të nevojshme të mbrojtjes nga zjarri;
- i. Gjithnjë dhe drejtpërdrejtë të kontrollojë ndërmarrjen e masave të nevojshme kundër zjarrit në kuadër të njësisë punuese;
- j. Të kujdesit që kaldajat, pajisjet dhe instalimet tjera duhet të jenë të pastruara nga mbeturinat, yndyra dhe lëndët djegëse. Lëndët djegëse të jenë të deponuara në vende të sigurta, ndërsa leckat e përlyera të vihen në enë që janë rezistuese ndaj zjarrit;
- k. Të ngritë fletëparaqitje kundër punonjësve të cilët shkelin detyrat e punës që nuk u përmbahen dispozitave të parapara të masave mbrojtëse;
- l. Të kujdeset në mbarëvajtjen e punëve të rrezikshme siç është p.sh. saldimi apo të ngjashme duke siguruar kujdestarët për fikje zjarri me mjete zjarrfikëse;
- m. Ta largojë nga vendi ku punohet cilindo punonjës i cili nuk u përmbahet masave të mbrojtjes nga zjarri;
- n. Të kryejë edhe punë të tjera të cilat janë në përputhshmëri me dispozitat e ligjit në fuqi, si dhe vendimet e organeve për udhëheqje dhe menaxhim në Ndërmarrje;

Neni 7

Obligimet e Punonjësit

1. Punonjësit e punësuar në Ndërmarrje janë të obliguar të zbatojnë masat e mbrojtjes nga zjarri e posaçërisht:
 - a. Gjatë kryerjes së punëve me mjetet për punë duhet të mbështeten në rregullat e mbrojtjes nga zjarri sipas udhëzimeve të prodhuesve dhe qëllimit të përdorimit të tyre, duke pasur kujdes; në çfarëdo mangësie, prishje ose ndryshim në mjetet e punës ose stabilimentit, nëse për këtë ekziston rreziku i shpërthimit të zjarrit;

- b. Janë të detyruar të punojnë dhe zbatojnë masat për mbrojtje nga zjarri, të marrin pjesë në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin e punonjësve, njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri sipas udhëzimeve dhe akteve të brendshme për menaxhim të Ndërmarrjes dhe në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.
- c. Duhet marr pjesë në trajnimet për aftësimin për punë në mënyrë të sigurt për mbrojtje nga zjarri;
- d. Të mbajë në gjendje të rregullt mjetet e punës dhe veglat me të cilat punon ose është përgjegjës për funksionimin e tyre, sidomos në aspektin e mbrojtjes nga zjarri;
- e. Gjatë caktimit në detyra të posaçme duhet të jetë i njoftuar me rreziqet nga zjarri dhe me masat për mbrojtje nga zjarri;
- f. T'iu përmbahen udhëzimeve për punë të sigurt nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimit dhe udhëzimeve të udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe veprimeve në vendi i punës;
- g. Duhet marrë pjesë në fikjen e zjarrit, evakuimin, shpëtimin e punonjësve dhe të mirave materiale;
- h. Në intervenimet për fikjen e zjarrit dhe shpëtimin të silltet sipas kërkesave të udhëheqësve të fikjes së zjarrit ose punonjësve përgjegjës për evakuim dhe shpëtim;
- i. Të respektojë ndalimin e pirjes së duhanit dhe përdorimi i flakës në çfarëdo mënyrë, në zonat e rrezikshme dhe në të gjitha vendet tjera ku kjo është e ndaluar.
- j. Të kryej punët me kujdes sipas rregullave të Ndërmarrjes, për tu ofruar siguri të plotë nga zjarri dhe shpërthimi;
- k. Të jetë i informuar me organizatat për mbrojtje nga zjarri dhe për mënyrat e organizimit për fikjen e zjarrit;
- l. Në mënyrë detale të jetë i njoftuar me procesin teknologjik dhe stabilimentet, me specifikat e rrezikshmërisë nga zjarri dhe shpërthimi dhe masat e mbrojtjes prej tyre;
- m. Të kontrollojë rrethinën e punës së vet dhe të shkyçë energjinë elektrike nëse ky proces nuk e ndikon operimin normal të ndërmarrjes pas përfundimit të punës;
- n. Të jenë i njoftuar në tërësi me të gjitha mjetet për fikjen e zjarrit, të cilat kanë të bëjnë me detyrat e punës së tij, me njësinë punonjëse të tij/saj;
- o. Duhet të ketë njohuri elementare për punën dhe mënyrën e përdorimit të aparateve të zjarrfikëse, fikjen e zjarrit me mjete për fikje;

Neni 8

Obligimet e Shërbimit për Siguri dhe Mbrojtje nga Zjarri - Zyrtarit për Mbrojtje nga Zjarri

1. Shërbimi i sigurimit dhe mbrojtjes nga zjarri kryen punët në mënyrë profesionale nga fushë veprimtaria e mbrojtjes nga zjarri edhe atë posaçërisht:
 - a. Kryen mbikëqyrjen mbi zbatueshmerinë e masave të parapara kundër zjarrit;
 - b. Merr pjesë në përgatitjen dhe hartimin e rregulloreve, vendimeve dhe urdhëresave në lidhje me mbrojtjen nga zjarri dhe propozon miratimin e tyre nga organet ose personat kompetent në ndërmarrje;
 - c. Propozon ndërrimin ose plotësimin e rregulloreve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe planit të mbrojtjes nga zjarri;
 - d. Bën analiza, mbledhë informata dhe harton raporte për gjendjen e mbrojtjes nga zjarri;
 - e. Bën analiza të drejtpërdrejta dhe ofron udhëzime apo vërejtje për departamentin apo objektet e caktuara lidhur me mbrojtjen nga zjarri, duke pasur parasysh specifikat e tyre si dhe veprimet që duhet ndërmarr në rast të shpërthimit të zjarrit.
 - f. I propozon Kryeshefit Ekzekutiv, ndaljen e punës në repartet e caktuara nëse është vërejtur ndonjë rrezik nga zjarri, deri sa të evitohet rreziku;
 - g. Organizon dhe mban evidencë të nevojshme nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri;
 - h. Inicion dhe përgatit këshillime të udhëheqësve dhe shërbimeve profesionale në të cilat shqyrtohet problemi i mbrojtjes dhe masat për përmirësim të këtij shërbimi.
 - i. Propozon marrjen e masave mbrojtëse për të parandaluar rreziqet nga zjarri në proceset teknike, deponimet e mbeturinave apo të lëndëve të ndezshme;
 - j. Propozon marrjen e masave kundër personave të cilët kanë bërë shkelje të detyrave të punës nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri;
 - k. Punon edhe punë të tjera të cilat me akte të brendshme vihen në përgjegjësi të tij;
 - l. Bashkëpunon me udhëheqësit e departamenteve nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri;
 - m. Të bashkëpunoj me shërbimin e sigurimit nga zjarri për çështjet të cilat kanë të bëjnë me disa masa të caktuara të mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimi;
 - n. Të paraqes fletëparaqitje kundër cilitdo punonjës që vepron në kundërshtim me këtë Rregullore dhe aktet tjera për mbrojtje nga zjarri;
 - o. Të ndërpres punën pa u hamundur në rast të shpërthimit të zjarrit apo shpërthimit dhe të marr pjesë e të organizoj fillimin e fikjes së zjarrit;

- p. Në zonat e rrezikshme të jap urdhëresë për ndalimin e mbajtjes së materialit që është vetëndezës, përdorimin e mjeteve dhe veglave që shkaktojnë xixa, apo përdorimin e mjeteve elektrike që nuk janë të sigurta;
- q. Njofton me rregullat dhe mënyrën e aftësimit të punonjësve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe përdorimin e pajimeve dhe mjeteve për fikjen e zjarrit. Me mënyrën e tërheqjes së vërejtjes punonjësve, zbatimi teorikë dhe praktikë, kontrollimi i njohurive me rastin e fillimit të punës ose kalimit nga një punë në tjetrën për rrezikun nga zjarri;

Neni 9

Obligimet e rojës-zjarrfikësit

1. Çdo rojtar-zjarrfikës dhe punonjës duhet të ketë njohuri për rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes nga zjarri.
2. Të gjithë rojet-zjarrfikësit dhe personat të cilat kryejnë apo bëjnë zëvendësimin e rojës-zjarrfikësit, duhet të jene të afte për mbrojtje nga zjarri dhe për fikjen e zjarrit.
3. Janë të obliguar t'i nënshtrohen trajnimit dhe të kryejnë testimin për zjarrfikës, duhet të aftësohen që të punojnë me aparate për zjarr fikje si dhe të veprojnë sipas dispozitave të kësaj rregullore dhe detyrës së tyre të rojtarit - zjarrfikësit;
4. Janë të detyruar që të mbajnë shënime në librin e hyrje-daljeve të automjeteve dhe personave si dhe librin e kujdestarisë.
5. Kanë për detyrë që rregullisht të kontrollojnë oborrin dhe hapësirat e Ndërmarrjes, duhet të kontrollojnë zonën e deponimit të biomasës si dhe të sigurojnë që në oborrin e Ndërmarrjes nuk gjenden njerëz të panjohur e që nuk janë punëtor të ndërmarrjes.

Neni 10

Kërkesat për Mbrojtje nga Zjarri në Dokumentacionin Teknik

1. Dokumentacioni teknik i objektit të Ndërmarrjes (Projekti) duhet të ketë vërtetimin e Inspektoratit për mbrojtje nga zjarri i cili argumenton se janë marre masa për mbrojtje nga zjarri në pajtim me specifikimin teknik dhe rregullat teknike për mbrojtje nga zjarri.
2. Pa vërtetimin e këtyre masave, organi kompetent për dhënien e lejes së ndërtimit nuk duhet të lëshoj lejen për punët e ndërtimitarisë.
3. Leja për përdorimin e objektit të ndërtuar, re-konstruktuar apo adaptuar të Ndërmarrjes, mund të lëshohet kur të vërtetohet se janë ndërmarr masat mbrojtëse nga zjarri të parapara në dokumentacionin teknik, të cilin e vërteton komisioni për kontrollimin teknik të objektit, në të cilin komision merr pjesë detyrimisht përfaqësuesi i inspektoratit për mbrojtje nga zjarri, i cili e vërteton se janë ndërmarrë masat mbrojtëse kundër zjarrit.
4. Nëse me rastin e kontrollimit teknik të objektit vërtetohet se në ndërtimin e objektit nuk janë zbatuar masat për mbrojtjen nga zjarri të parapara në dokumentacionin teknik nuk do të lëshohet leja për përdorimin e objektit derisa këto masa të mos aplikohen.

5. Për të gjitha pajisjen dhe mjetet e destinuar për zjarr fikje, lajmërim dhe parandalim të përhapjes së zjarrit të cilat janë instaluar duhet të ketë dokumentacion teknik adekuat, të jenë të certifikuar dhe të normëzuara sipas standardit Evropian EN 3.
6. Për numrin e parapare të përdoruesve të objektit, rrugët dhe dalje të evakuimit duhet të mundësojnë evakuim të shpejtë dhe të suksesshëm në rast zjarri.
7. Bazuar në elaboratin kundër zjarri është e nevojshme që në objekt të instalohet dhe të jetë funksional sistemi për zjarre fikje automatike, sprinkler me ujë.
8. Objekti duhet të ketë në vend ku shihet në afërsi të hyrjeve, udhëzimet për rast zjarri dhe planin e objektit me shënimet:
 - a. Në rrugëve për dalje dhe vendet ku janë të vendosur aparatet zjarrfikës
 - b. Në vendit ku është vendosur çelësi kryesor i furnizimit me energji elektrike
 - c. Në vendit për ç 'kyçe të sistemit të ajrosjes
 - d. Në shënimeve me vendet me rrezik të shtuar
 - e. Në planit të thjeshtëzuar të katit dhe daljeve emergjente.

Neni 11

Instalimet Qendrore për Fikje të Zjarrit, Hidrantët dhe Mirëmbajtja e Tyre

1. Instalimet apo pajisjet për fikje të zjarrit si dhe rrjetit të hidrantëve, duhet të projektohen dhe instalohen në pajtueshmëri me kriteret teknike për mbrojtje nga zjarri bazuar në destinimin e hapësirave dhe rrezikshmërinë në aspektin e mbrojtjes nga zjarri.
2. Për instalimin e pajisjeve statike të destinuar për lajmërimin dhe fikjen e zjarrit, detektimin e gazrave dhe avujve të ndezshëm, si dhe pajimet tjera mbrojtëse dhe instalimeve të cilat shërbejnë për evitimin e shkaktimit dhe zgjerimin e zjarrit dhe shpërthimit, kryesi i punëve është i detyruar të sigurojë dëshminë nga prodhuesi për funksionim të rregullt të tyre dhe procesverbalin mbi verifikimet e kryera nga personi juridik i autorizuar.
3. Instalimet për pajisje për fikje të zjarrit, rrjetit të hidrantit, duhet të kontrollohen së paku një herë në vit nga personat e autorizuar.
4. Përdorimi dhe mirëmbajtja e instalimeve të tilla bëhet sipas udhëzimeve të posaçme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullte dhe të gatshëm për t'u përdorur në çdo kohë.
5. Çdo punë që bëhet në instalime apo mirëmbajtje të sistemit të hidrantëve dhe rrjetës për fikje qendrore duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos dëmtohen dhe të mos zvogëlohet kapaciteti i tyre, posaçërisht të heqja ose rregullimi i valvuleve dhe pjesëve tjera, duhet siguruar që pjesët e dëmtuara të zëvendësohen me të reja dhe të montohen menjëherë.
6. Testimi i gjendjes së këtyre instalimeve bëhet së paku njëherë në vit dhe të shoqërohet në mënyrë të shkruar me evidencë ose procesverbal. Duhet të testohen të gjithë parametrat e kapacitetit, rrjedhjes dhe të presionit. Me rastin e kontrollimit mbahet procesverbal në të cilën shënohet se kur është bërë kontrollimi, kush e ka kryer dhe çfarë është vërtetuar nga kontrolli.

7. Aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.
8. Pajisjet për zbulimin dhe lajmërimin automatik të zjarrit, duhet të instalohen në të gjitha hapësirat në zonën e një sektori të zjarrit. Sinjali i lajmërimit të zjarrit duhet të përcillet në qendrën e kontrollit ose në qendrën përkatëse të menaxhimit apo lajmërimit për zjarr.
9. Aparatet zjarrfikëse të dorës të cilat janë të montuara në mure duhet të jenë për të gjitha qëllimet, nën presion të azotit, të tipit me pluhur kimik. Aparatet zjarrfikëse duhet të ofrohen tek secili objekt gjate punimeve. Aparatet zjarrfikëse duhet t'i përshtaten standardeve ndërkombëtare për industri EN3, duhet të jenë 9 dhe 50 kilogram dhe ngjyra duhet të jetë e kuqe të vendosura në mbajtëse muri.

Neni 12

Pajisjet për Fikjen e Zjarrit, Llojet dhe Sasia e Tyre

1. Mjetet për fikjen e zjarrit janë: aparatet zjarrfikëse, pajimet, instalimet e hidrantëve dhe veglat tjera për fikjen e zjarrit.
2. Llojin dhe sasinë e pajisjeve dhe mjeteve për mbrojtje nga zjarri e propozon shërbimi për sigurimi në bashkëpunim me sektorin teknik, si dhe në bazë të vendimit dhe elaboratit të organit kompetent të autorizuar për mbrojtje nga zjarri.
3. Pajimet duhet përshtatur sipas kushteve specifike në bazë të prodhimit si dhe numrit dhe llojit të pajimeve për fikjen e zjarrit.
4. Duhet të jenë në numër të mjaftueshëm dhe të vendosura në hapësirat e objektit që është i rrezikuar nga zjarri.
5. Pajimet dhe mjetet që gjenden në hapësirat dhe objektet e Ndërmarrjes duhet të jenë të vendosura në vende të përshtatshme dhe lehtësisht të qasshëm për përdorim.
6. Përshkrimi i llojit, sasisë dhe madhësisë së aparateve për fikje të zjarrit si dhe mjeteve dhe pajimeve duhet të përfshihen në elaboratin e mbrojtjes nga zjarri (MZ).
7. Për kontroll, kërkesën për servisim dhe mirëmbajtjen e aparateve zjarrfikëse, mjeteve dhe pajimeve për fikjen e zjarrit si dhe afatet e tyre e bënë zyrtari ngarkuar me punët për mbrojtje nga zjarri.
8. Aparatet zjarrfikëse të dorës të cilat janë të montuara në mure duhet të jenë për të gjitha qëllimet, dhe nën presion dhe të kenë mundësi të ofrohen tek secili objekt gjate punimeve.

Neni 13

Shënjëzimi i pajisjeve për fikje të zjarrit

1. Aparatet dhe pajisjet për fikjen e zjarrit nuk duhet të vendoset drejtpërdrejt tek aparatet elektrike të cilat mjeti për fikjen e zjarrit është përçues elektrik.
2. Aparatet dhe pajisjet nga paragrafi 1 këtij neni, duhet të mbajnë shenjën se ato nuk duhet të përdoren për shuarjen e zjarreve në pajisjet elektrike nën tension.

3. Të gjitha pajisjet për përdorimin e sistemit statik për fikje të zjarrit duhet të jenë qasshme dhe të shënuara qartë me ngjyrat dhe mbishkrimet e duhura, me shenjat për drejtimin e vëndrindodhjes së tyre. Për qasje sipas nevojës duhet vendosur mbishkrime të veçanta.

Neni 14

Masat mbrojtëse nga zjarri

1. Të gjithë punonjësit e punësuar në Ndërmarrje, si dhe instaluesit e pajisjeve janë të obliguar të njihen me rregullat për mbrojtjen nga zjarri, dhe me masat e aprovuara sipas planit për mbrojtjen nga zjarri.
2. Çfarëdo aktiviteti punë kryes apo projektues kur realizohet brenda për Ndërmarrje duhet të paraqes masat mbrojtëse të parapara në forme të dokumentacionit teknik ashtu që në bazë të paraqitjeve grafike dhe shpjegimeve tekstuale mund vlerësohet sistemi i zgjedhur për mbrojtjen nga zjarri, funksionaliteti dhe efikasiteti i tyre.
3. Me rastin e projektimit apo ndërtimit të objekteve në të cilën punojnë punëtorët, duhet të sigurohen kushtet të cilat mundësojnë që punëtorët në rast rreziku pa pengesa dhe shpejt të mund të dalin nga objekti.
4. Punët me zjarr, hark elektrik, saldim, prerja me autogjen, nxehje, shpim etj. duhet të behën në përputhje me rregullat mbi masat e mbrojtës nga zjarri.
5. Në Objektet e ndërmarrjes duhet të jene instaluar sistemi për mbrojtje nga zjarri i shkaktuar nga zrazja elektrike atmosferike - rrjetin e rrufepritës me për tokëzues. Rrjeti i rrufepritës për mbrojtjen e objektit nga zrazja atmosferike mundëson që të zvogëlohet rreziku nga dëmtimet të shkaktuara nga rrufeja në objekt apo dëmtimeve të tjera të cilat mund të shkaktohen si pasojë sekondare e goditjes.
6. Mbrojtja e pastër e hapësirave të punës në të cilat përdoret material i djegshëm është një kërkesë thelbësore për sigurinë.
7. Shtimgni stoqet e thasëve dhe materialit të pa paketuar ndërmjet makinerisë.
8. Për të zvogëluar sasinë e pluhurit të lëshuar në mjedis, mbani të pastërta të gjitha pajisjet dhe tubacionin.
9. Në mënyrë që të zvogëlohet rreziku nga zjarrit dhe ndikimi negativ në funksionalitetin e komponentëve, shpesh kërkohet pastrim i plotë. Motorët duhet të mbahen pa depozitime pluhuri dhe papastërtish.
10. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet gjatë operimit me pajisje salduese elektrike, pajisje prerëse me oksiacetilen dhe proceseve të tjera që mund të shkaktojnë ndezje-zjarr.
11. Duhet që të largohen çfarëdo mbeturine apo material ndezës dhe të marren të gjitha hapat që të eliminohet rreziku nga shkaktimi i zjarrit.
12. Duhet kushtuar kujdes i veçantë në vendet ku kryhen punime që potencialisht mund të jenë të rrezikshme për fillim dhe përhapje të zjarrit, siç janë:
 - a. Vendet e deponimit dhe vendosjes së lëndës së parë - Biomasesë

- b. Vendet e deponimi i bombolave te gazrave
 - c. Kthinat e vendosjes se mjeteve të pastrimit
 - d. Deponitë e mbetjeve ndërtimore
 - e. Vendet ku janë instaluar pajisjet, stabilimentet, instalimet qe mund te shkaktojnë fillim dhe përhapje të zjarrit (zona e kaldajave, stabilimentet elektro-energjetike, ormanët elektrik, sistemi i ndriçimit, etj.)
 - f. Vendet ku përdoret zjarri i hapur
 - g. Vendet ku përdoren mjeteve e punës qe shkaktojnë shkëndi
 - h. Vendet ku mund te ndezën materialet e ndryshme (mbeturinave)
 - i. Kur behet demolimi
 - j. Me rastin e lëshimit në punë të instalimeve të ndryshme
13. Me qëllim te parandalimit te ndezjes dhe përhapjes se zjarrit dhe me qëllim qe zjarr fikja të jetë sa me efikase, është e nevojshme që të merren masa organizative dhe teknike, gjate kohës së orarit te rregullt të punës dhe mbas tij, dhe të kushtohet kujdes në:
- a. Masat e përcjelljes dhe kontrollës së hyrjeve dhe daljeve (monitorimi, shërbimi i rojeve, etj.)
 - b. Masat e ndalimit të qarkullimit të automjeteve apo qarkullimi i kufizuar i tyre;
 - c. Masat e ndalimit apo hyrjes se kontrolluar të materieve të rrezikshme te cilat janë të nevojshme për ndërtim dhe kryerje të punëve;
 - d. Masat e evidentimit, vërejtjeve dhe informimit për rrezikun dhe aplikimi i masave të nevojshme për mbrojtje nga zjarri;
 - e. Aftësimi i personelit për implementimin e masave preventive te mbrojtjes nga zjarri, fikjen ne zjarreve fillestare dhe shpëtimin e njerëzve dhe pronës së kanosur nga zjarri;
 - f. Zgjedhja e vendit dhe kushtet e mbajtjes dhe deponimit te materieve të rrezikshme të lehtë ndezshme apo shpërthimit (perimetri i sigurisë, shenjat e rrezikut, mjetet doracake zjarrfikëse);
 - g. Masat e mbrojtjes nga zjarri gjate kryerjes se punëve te cilat mund te shkaktojnë zjarr (saldimi, prerja e metaleve, smaltimi, puna me zjarr te hapur, punët hidroizoluese, etj.)
 - h. Masat e sigurimit të qasjes së pa penguar të automjeteve zjarrfikëse;
 - i. Mënyrave të sjelljes dhe lajmërimit në rast te zjarrit;
14. Të caktohet personi përgjegjës për mbarëvajtjen e masave te mbrojtjes nga zjarri.

Neni 15

Veprimet në Rast Zjarri

1. Të vepohet sipas planit të mbrojtjes nga zjarri dhe të thirret njësi i zjarrfikësve të qytetit.
2. Me të gjitha mjetet në dispozicion për fikjen e zjarrit të vazhdohet fikja e zjarrit, të përdoren aparate me kapacitet më të madh për fikje të zjarrit.
3. Stabilimentet statike për fikjen e zjarrit dhe nyjet e hidrantëve duhet vënë në veprim të plotë, ndërsa disa prej tyre të hapen dhe të përdoren për fikjen e zjarrit.
4. Të mbrohen objektet tjera dhe të pengohet zgjerimi i zjarrit.
5. Në rast të zjarrit në automjet - Instalimi elektrik duhet menjëherë të shkyçet nga burimi i rrymës nga akumulatori dhe të vazhdohet me fikjen e zjarrit në automjet me anë të aparatit zjarrfikës.
6. Në rast të shpërthimit të zjarrit në automjetin për intervenim, fikjen duhet bërë gjithashtu me aparat zjarrfikës.
7. Duhet larguar automjetet tjera të rrezikuara nga zona e përfshirë nga zjarri.

Neni 16

Veprimet e Punonjësit në Rast të Shpërthimit të Zjarrit.

1. Secili punonjës i Ndërmarrjes i cili vëren rrezik të drejtpërdrejtë nga shpërthimi i zjarrit ose zjarr, është i obliguar që menjëherë ta largojë rrezikun, gjegjësisht ta fikë zjarrin me të gjitha mjetet për fikjen e zjarrit që ka në disponim, nëse këtë mund ta bëjë pa rrezik për vete ose personat tjerë.
2. Nëse punonjësi nuk mund ta fikë vetëm zjarrin, është i detyruar që menjëherë të lajmëroj të gjithë punonjësit tjerë në afërsi dhe punonjësin përgjegjës për të lajmëruar njësitin e zjarrfikësve që të kërkojë ndihmën e tyre.
3. Të gjithë punonjësit e pranishëm janë të detyruar që menjëherë, të organizuar të angazhohen në fikjen e zjarrit duke përdorur mjetet e nevojshme dhe pajimet për fikjen e zjarrit, të veprojnë me qëllim të mbisundimit mbi zjarrin dhe të ndërprejnë përhapjen e tij.
4. Me arrijtjen e njësisë së zjarrfikësve në vendin e zjarrit, të gjitha masat dhe komandën për fikjen e zjarrit e merr mbi vete njësi e tyre përkatësisht komandanti i njësisë së zjarrfikësve.

Neni 17

Rrobat dhe përdorimi i tyre në rast zjarri

1. Është e ndaluar të punohet me rroba me yndyrë apo vajra dhe të përlyera nga lëndë djegëse.
2. Rrobat e lagura nga derivatet e naftës në kontakt me flakën e hapur ose xixat shumë lehtë mund të ndizen dhe të shkaktojnë djegieje të rënda dhe vdekjeprurëse.

3. Fikja e zjarreve të tilla në njerëz bëhet me mbështjelljen e njeriut me rroba të zakonshme dhe shtrirjen e të djegurit në tokë. Në këto raste është i nevojshëm intervenimi i shpejtë i mjekësor.
4. Rrobat e punës nuk guxojnë të lahen e as të fërkohen me benzinë.
5. Rrobat mbrojtëse dhe mbathjet duhet mbajtur në dollap të gardërobës dhe ato duhet mbajtur të pastërta.

PUNA NË HAPËSIRA ME RREZIKSHMËRI TË LARTË PËR ZJARR

Neni 18

Saldimi dhe Mbikëqyrja në Rast Saldimi

1. Saldimin mund ta bëjnë punonjësit të cilët janë profesionalisht të aftë për përdorimin e mjeteve për saldim dhe të njoftuar me rregullat dhe masat për mbrojtje nga zjarri të cilat duhet ndërmerren gjatë saldimit.
2. Udhëheqësi i drejtpërdrejt nuk guxon të lejoj që saldimin ta bëjnë punonjësit të cilët nuk i plotësojnë kushtet e parapara.
3. Nëse saldimi duhet të behët në zonën me rrezikshmëri të lart për zjarr, saldimi duhet të kryhet në përkujdesjen e udhëheqësit të drejtpërdrejt edhe atë në mënyrën dhe kohën që është përcaktuar me lejen për saldim.
4. Udhëheqësi i Punimeve, pas marrjes së lejes për saldim, është i obliguar të vërtetojë masat që duhet marrë për mbrojtje nga zjarri në vendin e paraparë për saldim si dhe të vërtetojë se a është evituar mundësia e shkaktimit të zjarrit apo shpërthimit në hapësirat fqinjë ku do të saldohet.
5. Udhëheqësi i punimeve duhet të ndërmerr masat e duhura për evitimin e pengesave eventuale para fillimit të punimeve me saldim afër materialeve ndezëse, vendosjen e mjeteve mbrojtëse nga të gjitha anët e saldimit, largimin e koncentrimit të gazit ndezës, ose pluhurit, vendosjen e kujdestarisë zjarrfikëse etj.
6. Pas kryerjes së saldimit, vërtetohet se a janë kryer të gjitha punët dhe se a mos ekziston rreziku potencial i shpërthimit në zonën ku është kryer puna me saldim.
7. Veprimet në rast të shkaktimit të zjarrit, punonjësit të cilët bëjnë saldimin menjëherë duhet të angazhohen në fikjen e zjarrit me të gjitha mjetet me të cilat disponojnë, por nëse nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë, janë të obliguar që menjëherë të thërrasin ndihmë nga punonjësit tjerë dhe nga njësitë zjarrfikëse.
8. Në raste kur kërkohet intervenime për riparim dhe montim duke përdorur sisteme saldimi, këto punë duhet të kryhen në ofiçina ose vende pune të destinuara posaçërisht për këto lloj pune nëse është e mundur. Si përjashtim, punimet e saldimit dhe të ngjashme në dhomat e prodhimit ose magazinimit mund të kryhen vetëm nëse janë marrë masat e mëposhtme të sigurisë:

- a. Shtroni pëlhura të lagura ose speciale për të mbuluar zonën përreth;
 - b. Mbani vendndodhjen e saldimit dhe rrethinat e tij nën mbikëqyrje për të paktën 10 orë;
 - c. Kur largohet nga impianti, operatori i makinës duhet të udhëzohet të kujdeset për burimet e mundshme të zjarrit gjatë kësaj kohe;
9. Pikat (shkëndijat e saldimit) që spërkatën gjatë prerjes me zjarr të hapur janë shumë të rrezikshme. Ato mund të bien nëpër boshllëqe të ngushta, hapje muri dhe të ngjashme në hapësirat poshtë ose ngjitur me të. Nëse shkëndijat e saldimit bien në një shtresë pluhuri, duhet të pritët një zjarr që digjet gjatë gjithë kohës.
10. Puna e saldimit në sistemet e transportit që janë në veprim nuk duhet të kryhet në asnjë rrethanë.

Neni 19

Kërkesa për Leje për Pune me Saldim

1. Leja jepet në bazë të kërkesës së kryesit të punës me saldimit.
2. Kërkesa për dhënien e lejes për saldimit duhet të përmbajë:
 - a. Emri i njësisë punuese: vendet ku do të bëhen punët me saldimit, apo zjarr të hapur (flakë);
 - b. Përshkrimi i punëve;
 - c. Koha e kryerjes së punëve-afati;
 - d. Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të punëve;
 - e. Nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës;

Neni 20

Leja për Saldim

1. Leja për saldimit duhet të përmbajë:
 - a. Emërtimi i dhënësit të lejes;
 - b. Numri dhe data e dhënies;
 - c. Emri i njësisë punonjëse dhe vendi ku do të kryhen punët;
 - d. Përshkrimi i punëve;
 - e. Koha e kryerjes së punëve;
 - f. Masat mbrojtëse të cilat duhet marrë me qëllim të kryerjes së punëve;
 - g. Pajimet e nevojshme dhe mbrojtëse si dhe numrin dhe llojin e aparateve zjarrfikëse;

- h. Vërtetmini për kryerjen e punëve;
 - i. Emri dhe mbiemrin i udhëheqësit përgjegjës të punëve;
 - j. Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i dhënësit të lejes.
2. Formularët për zbatim të rregullave për mbrojtje nga zjarri për kryerjen e punëve salduese në vendet e përkohshme gjenden në shtojcën e kësaj rregulloreje

Neni 21

Mosdhënia e Lejes për Saldim

Leja për saldim nuk guxon të jepet në rastet si me poshtë:

- a. Për vendet që nuk janë të përgatitura për saldim;
- b. Në hapësirat me mjete automatike për fikjen e zjarrit, nëse këto mjete janë të bllokuara ose nëse nuk funksionojnë;
- c. Nëse ekziston rreziku për shpërthim për shkak të gazrave djegëse, avullit ose pluhurit në ajër, instalimeve dhe pjesëve tjera të stabilimenteve në të cilat ka pasur materie të cilat mund të krijojnë ndezje apo shpërthim të cilat janë të rrezikshme për shkak të zjarrit dhe shpërthimit;
- d. Kur saldimi duhet të bëhet në hapësirat në afërsi të cilave janë të deponuara sasi të mëdha të materieve që ndizen lehtë apo shpërthimit ose materieve tjera djegëse, nëse me këtë direkt do të rrezikohej pasuria dhe njerëzit;

Neni 22

Vendet e Përhershëm për Saldim

- 1. Vendet e përhershme për saldim janë punëtoritë apo vendet ku paraqitet nevoja teknike që dunet bëhet saldimi apo të punohet me flakë çdoherë apo me ndërprerje të shkurtra kohore.
- 2. Këto vende të punës duhet të jenë nga materiali jo djegës apo nga konstruksioni që i reziston zjarrit dhe të mbrojtura nga sipërfaqet në afërsi të hapësirave dhe objektit.

Neni 23

Vendet e Përkohshme për Saldim

- 1. Vendet e përkohshme për saldim janë ato vende ku bëhet saldimi sipas nevojës dhe përkohësisht në kohë, sipas kushteve të caktuara me leje të veçanta.
- 2. Saldimi në vende të përkohshme mund të aplikohet vetëm me leje të dhëna nga punonjësi përgjegjës për punë teknike.

Neni 24

Punëtorja

1. Mbrojtja nga zjarri në punëtori duhet të jetë sipas dispozitave kundër zjarrit ndërsa për zbatimin e masave kundër zjarrit përgjegjës është udhëheqësi i njësisë së punëtorisë.
2. Për çdo saldimit në punëtori, në oborr të Ndërmarrjes dhe të instalimeve për mirëmbajtje dhe rekonstruktiv, udhëheqësi i punëtorisë duhet të gjejë vendin e caktuar se ku mund të saldohet dhe për punën me flakë dhe duhet dhënë leje.
3. Nuk guxon të bëhet saldimit në tubat instaluese dhe rezervarët në të cilët gjendet avulli i lëndëve që digjen lehtë, të gjitha tubë përcjellësit, rezervarët dhe enët me lëndë djegëse.
4. Përdorni dhe puna me aparate për saldimit me autogjen mund të bëhet vetëm sipas dispozitave për punë me këto aparate. Këto aparate duhet të kenë armaturë mbrojtëse dhe pajime.
5. Nuk guxon të bëhet gërryerje ose shpim me shpuese elektrike në zona të rrezikshme dhe afër enëve dhe instalimit me lëndë djegëse që digjen lehtë.
6. Është e ndaluar që në ofiqin të mbahet lëndë djegëse që digjen lehtë në enë të hapura.
7. Në ofiqin duhet të jetë vendi i caktuar për saldimit që është i përbalueshëm ndaj zjarrit.
8. Në secilin vend, shteg për saldimit duhet të jetë nga një aparat i zjarrfikës, është e ndaluar të saldohet jashtë vendit të caktuar për saldimit.

Neni 25

Instalimet Elektrike

1. Gjithmonë duhet instaluar sipas rregullave elektroteknike edhe në vendet ku ekziston rreziku nga zjarri.
2. Punimet në instalimet elektrike mund t'i bëjë vetëm personi-eksperti i kualifikuar.
3. Për të gjitha prishjet në instalimet elektrike punonjësit duhet të lajmërojnë shërbimin për mirëmbajtje të instalimit elektrik.
4. Të gjithë pajisjet që konsumojnë energji elektrike, elektromotorët, makinat dhe aparatet duhet të jenë të mbrojtura nga tensioni i lartë, nga qasje nga personat jo të autorizuar dhe dëmtimi i tyre.
5. Mbrojtja nga tensioni i lartë dhe qasja duhet kontrolluar rregullisht, ndërsa dëmtimet dhe keqfunksionimi duhet evidentuar në librin e mirëmbajtjes.
6. Kontrollin dhe matjen e tyre e bën shërbimi për mirëmbajtje të instalimit elektrik.
7. Për të gjitha kontrollet dhe matjet mbahet evidencë e caktuar me dispozita (procesverbalet, vërtetimet, libri i servisimit dhe lista kontrolluese).

8. Mbrojtja e instalimeve elektrike dhe stabilimenteve duhet të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare për mbrojtje nga zjarri.
9. Instalimet elektrike dhe pajisjet që përdoren duhet të kontrollohen rregullisht. Kushtojini vëmendje të veçantë: elektrikëve të dorës, kabllave zgjatuese.
10. Riparoni ose zëvendësoni menjëherë instalimet dhe pajisjet elektrike me defekt.
11. Largoni nëse kjo është e mundur kabllot e lira që shtrihen mbi dysHEME sepse ato rrisin rrezikun e aksidenteve.

Neni 26

Dritat dhe Ndiriçimi

1. Hapësira e përgjithshme e brendshme dhe e jashtme e Ndërmarrjes, duhet të jetë e ndriçuar mirë dhe sipas rregullave të parapara dhe normave dhe standardeve teknike.
2. Në vendet dhe hapësirat që trajtohen si zona të rrezikshme është e ndaluar të përdoren drita të zakonshme si dhe bateri të rëndomta dore.
3. Në vendet ku ekziston mundësia e shpërthimit të eksplozimit dhe zona tjera të rrezikshme duhet instaluar dhe përdorur drita dore të sigurta dhe të mbrojtura për të mos shkaktuar zjarr.
4. Secila dritë e tillë duhet të ketë atestimin e paraparë që e lejon përdorimin e saj në zona të rrezikshme.

Neni 27

Masat mbrojtëse Kundër Ngrirjes

Para filimit të periudhës me temperatura të ulëta është e domosdoshme që të merren masa mbrojtëse kundër ngrirjes së instalimit të tubave, enëve dhe pjesëve tjera që janë të mbushura me ujë. Për këtë arsye duhet lëshuar ujin nga tubat mbitokësorë përmes valvuleve të drenimit nëse këta tuba janë të parapara të qëndrojnë jashtë gjatë tërë kohës.

Neni 28

Parkimi i Automjeteve

1. Duhet vepruar në atë mënyrë që secili automjet të jetë në vendin e vet, caktimi i vendit të parkimit caktohet nga punëtori kompetent për mirëmbajtje të automjeteve.
2. Parkimi i automjeteve duhet të bëhet në atë mënyrë që secili prej tyre, në rast nevoje të mund të evakuohet nga vendi i parkimit.
3. Çelësat e automjeteve, pas kohës së punës duhet të jenë në automjete, ose të rojtari, ndërsa kabinat duhet të jenë të hapura.
4. Automjetet nuk guxojnë të parkohen në afërsi të rezervarëve apo depos me biomasë apo vendet tjera të rrezikshme që mund të ndezjen nga zjarrit.

Neni 29

Operimi me Mbeturina dhe Lecka

1. Leckat me yndyrë dhe mbeturinat duhet hedhur në enë metalike të posaçme me kapak dhe rregullisht duhet zbrazur.
2. Është e ndaluar të digjen leckat e yndyrshme dhe materiali mbeturinë, kartonët, plastika dhe të ngjashme, në zonat ku përbën rrezikshmëri.

Neni 30

Kontrolli i Brendshëm dhe Njoftimi mbi Zbatimin e Rregullores

Organizimi dhe mënyra e kryerjes së kontrollit të brendshëm, autorizimi dhe detyrat e punonjësve që e bëjnë këtë kontroll kryhet si vijon:

- a. Punonjësit me autorizim të posaçëm dhe përgjegjësi për mbrojtje nga zjarri bëjnë së paku dy herë në vit (çdo 6 muaj) kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri të parapara me planin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe menjëherë përmes bashkëpunësuesve të tyre (udhëheqësve të drejtpërdrejtë) marrin masa për evitimin e mangësive.
- b. Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes, për të gjitha çështjet e kontrollit të brendshëm dhe kontrollimeve të veçanta mund të caktoj personin e përshtatshëm, gjegjësisht shërbimin profesional të Ndërmarrjes.
- c. Kontrollin e zbatimit të Rregullores për mbrojtje nga zjarri dhe mirëmbajtjen e servisimit të aparateve të zjarfikësve e bene punonjësi përgjegjës i shërbimit të prodhimit të cilët janë të autorizuar me këtë Rregullore.
- d. Udhëheqësit e departamenteve dhe udhëheqësit e drejtpërdrejt janë përgjegjës për kontrollin dhe zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri.
- e. Çdo udhëheqës i drejtpërdrejtë është i obliguar që punonjësin e pranuar ose me ndërrimin e vendit të punës ta njoftoj me rreziqet dhe masat mbrojtëse nga zjarri, punën dhe vendin e punës në të cilin punon. Ai është i obliguar që nga punonjësi të siguroj zbatimin e masave mbrojtëse kundër zjarrit para fillimit të punës. Te kujdeset që punonjësi të zbatoj, të aftësohet dhe të ushtrohet për kryerjen e punës duke pasur për baze masat për mbrojtje nga zjarri. Veçanërisht çdo punonjës është i obliguar që të aftësohet për përdorimin e aparateve kundër zjarrit.

Neni 31

Kontrolli i Përditshëm në Objektet e Ndërmarrjes

3. Për kontroll të përditshëm vizual të masave dhe veprimeve ndaj detyrave dhe rregullave nga kjo Rregullore janë përgjegjës udhëheqësit e shërbimeve të Ndërmarrjes.
4. Njëherë në gjashtë muaj kontrollin e masave mbrojtëse nga zjarri si dhe servisimit të aparateve e kryen servisi i autorizuar.

5. Njëherë në vit bëhet kontrolli detal i masave dhe detyrave të caktuara, veprimeve dhe kushteve teknike nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri, të cilin e kryen zyrtari për mbrojtje nga zjarri, i cili gatë kontrollit mbanë procesverbal me afate të caktuara për evitim të mangësive dhe ia dorëzon Kryeshefit Ekzekutiv dhe udhëheqësit të shërbimit përkatës.
6. Për çdo ditë bëhet kontrolli i oborrit dhe kontrollohet zona e deponimit të biomasës.
7. Duhet pasur përkujdesje për gjithë aparaturën zjarrfikëse dhe mjeteve tjera për fikjen e zjarrit, për rregullsinë e tyre në mbushjen dhe vendosjen sipas rregullave të parapara me Rregullore.
8. Kujdes të posaçëm duhet vënë rregullsisë së deponisë, elementeve të panevojshme apo mbeturinave që mund të paraqesin rrezik për zjarr.
9. Punonjësit duhet udhëzuar për masa preventive të mbrojtjes, përdorimin e mjeteve dhe mënyrën e intervenimeve për fikjen e zjarrit.
10. Punonjësit e ri duhet njoftuar me të gjitha mjetet e nevojshme të mbrojtjes nga zjarri, të aftësohen për përdorimin të mjeteve dhe punëve për mbrojtje nga zjarri si dhe për masat të cilat kërkohen sipas kësaj Rregullore dhe planit të mbrojtjes nga zjarri.
11. Duhet bërë kontroll të automjeteve në aspektin e marrjes së masave të mbrojtjes nga zjarri, sidomos kur bëhet shkarkimi i lëndëve djegëse.
12. Objekti do të ketë në vend ku shihet në afërsi të hyrjeve, udhëzimet për rast zjarri dhe planin e objektit me shënimet:
 - a. Rrugët e daljes
 - b. Vendet ku janë të vendosur aparatet zjarrfikës
 - c. Vendin ku është vendosur çelësi kryesor i furnizimit me energji elektrike
 - d. Vendin për ç'kyqjen e sistemit të ajrosjes
 - e. Shënimin e vendeve me rrezik të shtuar
 - f. Në objekt duhet të jetë i vendosur plani i thjeshtëzuar i katit dhe daljeve emergjente

Neni 32

Lëvizja e Palëve

Njerëzve që nuk janë të punësuar në Ndërmarrje, afrimi në zonën e gjenerimit të energjisë dhe zonën për deponim të biomasës është i ndaluar, kjo duhet të shënohet në vend që duket qartë.

Neni 33

Trajnimet dhe Njohurit për Mbrojtje nga Zjarri

1. Secili punonjës i Ndërmarrjes, në rastin e paraqitjes në punë dhe në rastin e kryerjes së punëve dhe detyrave të punës, si dhe në rastin e transferimit nga një punë në tjetrën (kur ekziston rreziku nga zjarri) është i obliguar të trajnohet nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri.
2. Është obligative që punonjësit e ndërmarrjes të njoftohen me rreziqet për shpërthim zjarri në vend të punës, masat mbrojtëse, përdorimin e mjeteve dhe pajimeve për fikjen e zjarrit, veprimet në rast të shpërthimit të zjarrit si dhe për përgjegjësitë nëse nuk u përmbahet rregullave dhe masave të parapara për mbrojtje nga zjarri.
3. Punonjësit e Shërbimit Përgjegjës (për mbrojtje nga zjarri) njëherë në vit testohen në lidhje me përgatitjen e tyre në rast të intervenimi për mbrojtje nga zjarri.
4. Aftësimi i punonjësve bëhet sipas programit të organeve kompetente të sigurisë publike.
5. Ndërmarrja është e obligueshme që për kohën e mbajtjes së aftësimit të punonjësve nga lëmia i mbrojtje nga zjarri t'i lajmëroj organet e sigurisë publike — Policinë dhe Zjarrfikësit.
6. Përgatitja profesionale e punonjësit i cili i kryen punët e mbrojtjes nga zjarri duhet të jetë në përputhje me dispozitat e kësaj Rregullore dhe aktet tjera normative.

Neni 34

Përgjegjësia për Moszbatim të Masave apo Udhëzimeve për Mbrojtje nga Zjarri

1. Punonjësi i cili në punë nuk ndërmerr masa të mbrojtjes nga zjarri dhe i cili nuk u përmbahet rregullave të caktuara dhe udhëzimeve të dhëna për punë të sigurt për mbrojtje nga zjarri, i cili nuk i kryen punët dhe detyrat e parapara sipas kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera të përgjithshme për mbrojtje nga zjarri, ose i kryen kundër këtyre dispozitave, përgjigjet për shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe obligohet për kompensim të dëmit të shkaktuar.
2. Udhëheqësi i sigurimit dhe çdo punëtor i cili kryen shkeljen e detyrave të punës për mbrojtje nga zjarri është i obliguar të raportohet dhe kundër tij të ushtrohet fletëparaqitja.
3. Niveli i shkeljes (shkelje e lehtë apo e rëndë) së rregullave të punës që lidhen me masat për mbrojtje nga zjarri, trajtohen sipas Rregullores së Ndërmarrjes për marrëdhënie pune dhe përgjegjësi disiplinore.
4. Masa disiplinore për Shkelje të detyrave të punës shqiptohet sipas Ligjit të Punës dhe Rregullores për Marrëdhënie në punë.

Neni 35

Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

1. Me këtë Rregullore janë të obliguar të njihen të gjithë punonjësit e Ndërmarrjes, në mënyrë që të mund të veprojnë sipas dispozitave të sajë.
2. Punonjësit e rinj, para se të vendosen në vendet e punës, duhet njoftuar me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 36

Zbatimi

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është mbrojtje e jetës së personave dhe punonjësve të Ndërmarrjes si dhe pasurisë së saj.
2. Për zbatimin e masave të kësaj Rregullore dhe njoftimin me kohë të punonjësve me masat mbrojtëse në disa vende të punës me specifika të veçanta, në mënyrë të posaçëm kujdesat dhe përgjigjet udhëheqësi i departamentit dhe udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

Neni 37

Ndryshimi dhe Plotësimi





1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore behën nga organi i njëjtën i cili e ka miratuar këtë Rregullore.
2. Nëse ndonjë klauzole apo nen i kësaj Rregullore është në kundërshtim me Ligjin në fuqi, në ato raste mbizotëron Ligji në fuqi për mbrojtje nga Zjarri.

Neni 38

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" SHA në Gjakovë:


Kryesues,

Anëtarë/e,

Anëtarë/e,

Anëtarë/e,



Gjakovë, më.09.03.2023

KËRKESË PËR KRYERJEN E PUNËVE SALDUESE

Nr. i kërkesës _____ datë: _____ Muaji: _____ viti: _____

1. Vendi (reparti, njësia, sektori, hapësira e punës)

2. Përshkrimi i llojit të punës _____
3. Koha e kryerjes së punës _____
4. Lista e masave të marra me qëllim të sigurimit të punëve

5. _____

6. Personi i autorizuar për kryerjen e punëve:
7. Udhëheqësi i punëve _____
8. Salduesi _____

Parashtruesi i kërkesës (Emri dhe Mbiemri) _____

Janë të pajtimit:

Udhëheqësi i Njesisë: _____

Zyrtari për mbrojtje nga zjarri: _____

Data: _____

Nr. rendor i protokollit: _____

LEJE E PËR KRYERJEN E PUNIMEVE TË SALDIMIT

Në bazë të kërkesës nr. _____ nga ora _____ deri _____ të datës _____

1. Udhëheqësi i punimeve _____
(emri, mbiemri, funksioni)
2. Salduesi _____
(emri, mbiemri)
3. Vendi (reparti, njësia, sektori, makina)

4. Përshkrimi i llojit të punës që lejohet _____
5. Koha e kryerjes së punimeve data: _____ prej _____ deri _____
6. Lista e masave për mbrojtje kundër zjarrit të cilat duhet të merren në vendin e punës që planifikohet të kryhet saldimit

7. Është vërtetuar marrja e masave të kërkuara dhe pajtohem për kryerjen e punëve të saldimit:
Udhëheqësi i punimeve:
Emri Mbiemri, _____ Nënshkrimi, _____.
8. Kryerja e punimeve në përputhje me kushtet dhe kërkesat teknike të mbrojtjes

(zyrtari për mbrojtje kundër zjarri) (nënshkrimi)
9. Leja është valide nga ora: _____ deri _____ / _____ / _____
datë muaji viti

Udhëheqësi i Shërbimit

(emri, mbiemri) (nënshkrimi)
10. Vazhdimi i lejes: data _____ prej orës _____ deri _____
11. Pas kryerjes së punimeve salduese është vërtetuar se nuk ekziston rreziku i shpërthimit të zjarrit:

Udhëheqësi i Shërbimit Zyrtari për M.Z Udhëheqësi i Saldimit
